

VENDIM
Nr. 6, datë 12.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, dhe të paragrafit “vii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së Këshillit të Basenit Ujor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Deri në funksionimin e plotë të portalit elektronik të shërbimeve qeveritare në ofrimin e shërbimit për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e burimit ujor, shqyrtimi i dokumentacionit dhe propozimi për miratimin e lejes së autorizimit do të bëhen nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor.

3. Vendimi nr. 5, datë 16.2.2016, i Këshillit Kombëtar të Ujit, “Për miratimin e rregullore së “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
E KËSHILLIT TË BASENIT UJOR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim vendosjen e rregullave të përgjithshme për organizimin, funksionimin dhe procedurat me anë të të cilave Këshilli i Basenit Ujor do të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Neni 2
Fusha e veprimit

Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje është tërësia e veprimeve për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor, si dhe marrëdhëniet me institucionet, organet shtetërore, entet publike dhe subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e burimeve ujore.

Neni 3

Objekti

Objekti i rregullores është vendosja e rregullave dhe përcaktimi i procedurave të organizimit të mbledhjes, funksionimit dhe administrimit të veprimtarisë së Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 4

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **“AMBU”**: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
2. **“Autorizim”**: akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin, për menaxhimin e burimeve ujore dhe në ligjin për lejet dhe licencat;
3. **“Detyra”**: funksione, detyrime që i ngarkohen Këshillit të Basenit Ujor, nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Këshilli Kombëtar i Ujit
4. **“KBU”**: Këshilli i Basenit Ujor;
5. **“Kompetencë”**: të drejtat që i janë dhënë me ligj, akte nënligjore, apo nëpërmjet delegimit të kompetencave, Këshillit të Basenit Ujor, për të vendosur e për të zgjidhur një rreth të caktuar çështjesh në fushën e administrimit të burimeve ujore;
6. **“Kërkesë për leje/autorizim”**: kërkesat e subjekteve fizike, juridike, publike ose private për marrjen e autorizimit ose lejes për përdorim burimi ujor;
7. **“Leje”**: akti administrativ sipas kuptimit të dhënë në ligjin për lejet dhe licencat;
8. **“Projektvendim”**: vendimi i propozuar me karakter të përgjithshëm ose individual që rregullon një marrëdhënie juridike konkrete ose vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje;
9. **“ZABU”**: Zyra e Administrimit të Basenit Ujor.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 5

Organizimi i Këshillit të Basenit Ujor

1. Qendra, numri, përbërja, mandati dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. KBU-ja kryesohet nga prefekti i qarkut në të cilën ndodhet Qendra e Basenit Ujor. Kryetari do të jetë në funksion për aq kohë sa ushtron detyrën e prefektit.
3. Këshilli i Basenit Ujor zgjedh nënkryetarin nga anëtarët e tij.

Neni 6

Kompetencat dhe detyrat

1. Kompetencat e KBU-së përcaktohen në ligj dhe në aktet nënligjore.
2. KBU-ja ushtron dhe detyra të tjera të përcaktuara me akte nënligjore.

KREU III

PROPOZIMI I PROJEKTVENDIMEVE, LEJEVE, AUTORIZIMEVE

Neni 7

Propozimi i projektvendimit

1. Të drejtën e propozimit të projektvendimit për miratim në mbledhjen e KBU-së e ka kryetari, çdo anëtar, AMBU-ja dhe institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose vendore.

2. Kryetari, anëtari i KBU-së dhe institucionet e tjera shtetërore qendrore ose vendore ushtrojnë të drejtën e propozimit për çështje që përfshihen brenda fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore.

3. Anëtari i KBU-së dhe institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose vendore, ushtrojnë të drejtën e propozimit duke paraqitur pranë ZABU-së kërkesën me shkrim të drejtuesit të institucionit që përfaqësojnë.

4. AMBU-ja, vetë ose nëpërmjet ZABU-së, i propozon KBU-së aktet që rregullojnë marrëdhëniet juridike në fushën e menaxhimit të burimeve ujore brenda basenit përkatës.

5. Projektvendimi shoqërohet me përgatitjen e relacionit shpjegues, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare në rastet kur ka efekte financiare.

Neni 8

Propozimi i lejes, autorizimit

AMBU-ja, nëpërmjet ZABU-së, i propozon KBU-së dhënien e lejes, autorizimit për përdorimin e burimit ujor, kur veprimtaria kryhet brenda kufirit të basenit përkatës.

Neni 9

Bashkërendimi i projektvendimit

1. Kryetari ose anëtari propozues ia dërgon projektvendimin bashkë me relacionin shpjegues dhe dokumentacionin shoqërues, për mendim paraprakisht ZABU-së dhe, pasi bien dakord ndërmjet tyre, ZABU-ja ia dërgon për mendim kryetarit dhe institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KBU, bashkë me relacionin shpjegues dhe dokumentet shoqëruese.

2. Institucionet e parashikuara në pikën 1 e dërgojnë mendimin në formë shkresore, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendrike nga data e marrjes së tij. Nëse pas mbarimit të afatit mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se institucioni përkatës është dakord dhe pa vërejtje.

3. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose të kundërshtojnë tërësisht përmbajtjen e projektvendimit, kryetari, në rastet kur është propozues, anëtari propozues ose AMBU-ja mund të vendosë tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit ose të ndryshojë projektvendimin duke pasqyruar riformulimet e nevojshme.

Neni 10

Bashkërendimi i kërkesës për leje, autorizim

1. AMBU-ja dërgon për mendim nëpërmjet portalit qeveritar të shërbimeve elektronike kërkesën për leje, autorizim për përdorim burimi ujor, kryetarit, institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KBU, institucioneve të tjera që janë pjesë e bashkërendimit institucional në këtë proces dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit, anëtarë të KBU-së.

2. Institucionet e parashikuara në pikën 1 e dërgojnë mendimin e nënshkruar elektronikisht nga nëpunësi i autorizuar, nëpërmjet sistemit elektronik, jo më vonë se 7 ditë kalendrike nga

data e marrjes së tij. Nëse pas mbarimit të afatit mendimi i kërkuar nuk është dhënë, konsiderohet se institucioni përkatës është dakord dhe pa vërejtje.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshjeje për projektvendimet e propozuara ndërmjet anëtarëve të KBU-së ose ndërmjet anëtarëve me AMBU-në, ZABU-ja në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet anëtarëve dhe AMBU-së, kur mosmarrëveshja është me të, përgatisin një relacion shpjegues për përmbajtjen, problematikën si dhe zgjidhjen e mundshme të sugjeruar lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara dhe ia dërgon për shqyrtim dhe zgjidhje kryetarit të Këshillit të Basenit Ujor.

2. Në rast se mosmarrëveshja është ndërmjet AMBU-së dhe kryetarit dhe nuk zgjidhet ndërmjet tyre, atëherë palët ia kalojnë çështjen për zgjidhje kryetarit të Këshillit Kombëtar të Ujit.

3. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet AMBU-së dhe anëtarëve të KBU-së gjatë bashkërendimit të kërkesave për leje, autorizim për përdorim burimi ujor, AMBU-ja përgatit një relacion shpjegues për problematikën dhe e paraqet në mbledhjen e KBU-së.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJES

Neni 12

Rendi i ditës

1. Drejtuesi i ZABU-së, në bazë të propozimeve të AMBU-së dhe çështjeve të tjera të paraqitura, përgatit rendin e ditës së mbledhjes dhe ia propozon për miratim kryetarit.

2. Në rendin e ditës përfshihen: projektvendimi, kërkesa për leje, autorizim për të cilin/cilat ka përfunduar procedura e dhënies së mendimeve sipas neneve 9, 10, të kësaj rregulloreje.

3. Rendi i ditës përmban:

- a) datën dhe orën e caktuar për mbledhjen;
- b) tematikën që do të trajtohet;
- c) propozimet dhe kërkesat që do të shqyrtohen;
- ç) problemet e ndryshme që do të diskutohen;

3. Kryetari mund të përfshijë në rendin e ditës çështje për diskutim të cilat nuk janë propozuar nga drejtuesi i ZABU-së.

Neni 13

Thirrja e mbledhjes

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjes. Mbledhjet thirren si rregull, të paktën një herë në 2 (dy) muaj.

2. ZABU-ja njofton anëtarët e Këshillit të Basenit Ujor, AMBU-në për rendin e ditës, datën dhe orën e mbledhjes së Këshillit të Basenit.

3. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datës dhe orës së vendosur për mbledhjet i njoftohet anëtarëve dhe AMBU-së.

4. Kryetari është i detyruar ta thërrasë mbledhjen kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Në këtë rast, ZABU-ja bën njoftimin për thirrjen e mbledhjes brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës.

5. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret nga kryetari e, në pamundësi të tij, thirret nga nënkryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 14 **Organizimi**

1. ZABU-ja organizon punën për përgatitjen e mbledhjes së KBU-së.
2. Anëtarëve u vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga subjekti.
3. Anëtarët si rregull vihen në dijeni për rendin e ditës të shoqëruar me materialin përkatës, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.
4. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës dhe materialet shpërndahen të paktën 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

Neni 15 **Pjesëmarrja**

1. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari ose nënkryetari.
2. Drejtuesi i ZABU-së dhe përfaqësuesi i AMBU-së marrin pjesë rregullisht në mbledhje, pa të drejtë vote.
3. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve, drejtuesi vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, jo më pak se 48 orë pas të parës. Në këtë rast, mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 16 **Kryesimi dhe drejtimi i mbledhjes**

1. Mbledhja kryesohet dhe drejtohet nga kryetari.
2. Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga nënkryetari.
3. Drejtuesi i mbledhjes drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

Neni 17 **Zhvillimi i mbledhjes**

1. Mbledhja bëhet me dyer të mbyllura.
2. Me propozim të kryetarit, mbledhjet bëhen me dyer të hapura. Në këtë rast, ZABU-ja merr masa për njoftimin e palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të paktën 2 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Për arsye të motivuara, me propozim të kryetarit, për çështje të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës, këshilli mund të vendosë mbledhje jashtë radhe për shqyrtimin e tyre.
4. Prezantimi i projektvendimit bëhet nga propozuesi. Projektvendimi i hartuar nga organet apo institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose lokale, prezantohet në mbledhje nga kryetari.
5. Kërkesat për dhënie autorizimi ose leje të përdorimit të burimit ujor prezantohen nga drejtuesi i ZABU-së.
6. Pas prezantimit, drejtuesi i mbledhjes fton anëtarët të japin mendimet e tyre. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale.
7. Projektvendimi mund të tërhiqet nga propozuesi në çdo kohë, deri para votimit të tij.
8. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi i mbledhjes fton anëtarët për votim.

9. Drejtuesi i mbledhjes mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastin kur situata e përligj këtë veprim.

Neni 18

Konflikti i interesit

1. Dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore për konfliktin e interesit zbatohen për të gjithë anëtarët.
2. Anëtarët që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit.

Neni 19

Marrja e vendimit

1. KBU-ja merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës dhe për të cilat ka përfunduar procedura e bashkërendimit sipas neneve 9 e 10, të kësaj rregulloreje.
2. Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.
3. Anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë.
4. Vendimi merret me votim të hapur.
5. Drejtuesi i mbledhjes voton i fundit.
6. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë, përfshirë dhe votën e kryetarit, vota e kryetarit është vendimtare.
7. Kur rezultati i votimit është i barabartë dhe mbledhja drejtohet nga Nënkryetari, vendimi shtyhet në mbledhjen pasardhëse të kryesuar nga Kryetari.

Neni 20

Vendimi

Në përfundim të shqyrtimit të projektvendimit dhe/ose kërkesës për leje/autorizim, KBU-ja vendos:

- a) miratimin në gjendjen e paraqitur;
- b) miratimin me ndryshime;
- c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;
- ç) mosmiratimin.

Neni 21

Regjistrimi i mbledhjes

1. Mbledhja e KBU-së regjistrohet në procesverbal. Procesverbali mbahet nga nëpunësit e ZABU-së.
2. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
3. Procesverbali nënshkruhet nga punonjësi që e mban, Drejtori i ZABU-së dhe Drejtuesi i mbledhjes.
4. Në rastet kur mbledhja është e ndarë në seanca dhe Drejtuesi e shikon të arsyeshme, procesverbali nënshkruhet pas përfundimit të seancës së fundit.

5. Procesverballi u paraqitet, përpara mbledhjes pasardhëse, anëtarëve të KBU-s, nëse një gjë e tillë kërkohet nga vetë ata. Në këtë rast, anëtarët kanë të drejtë të paraqesin vërejtje për përmbajtjen e tij, kur nuk është pasqyruar saktësisht qëndrimi i tyre në mbledhje.

Neni 22

Hyrja në fuqi e vendimit

1. Vendimi me karakter normativ hyn në fuqi pas publikimit me mjetet e informimit publik.
2. Vendimi me karakter individual hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.
3. Leja apo autorizimi për përdorim të burimit hyn në fuqi pas publikimit të tyre në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve.

KREU VI

FORMALIZIMI, PUBLIKIMI, NJOFTIMI, ARKIVIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 23

Formalizimi, njoftimi, publikimi i vendimit, lejes, autorizimit

1. Vendimi i KBU-së formalizohet nga drejtuesi i ZABU-së dhe nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes.
2. Formulari i lejes dhe i autorizimit plotësohet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i vendimit nga drejtuesi i mbledhjes.
3. Vendimi formalizohet brenda 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga drejtuesi.
4. Vendimi formalizohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje mbahet në arkivin e prefektit, një mbahet në arkivin e ZABU-së, një kopje i dërgohet AMBU-së dhe një kopje subjektit të interesuar.
5. ZABU-ja merr masa për njoftimin e institucioneve, organeve shtetërore, personave, fizikë dhe juridikë, që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e vendimit.
6. Publikimi i vendimit bëhet në faqen zyrtare të ZABU-së ose nëpërmjet njoftimeve publike.

Neni 24

Vula dhe protokolli

1. KBU-ja ka vulën zyrtare me të cilën identifikohet.
2. Vula ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare. Vula përmban shënimin identifikues “Këshilli i Basenit Ujor”.
3. Vula administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ruhet në kasafortë dhe përdoret vetëm nga punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë në rastet e shoqërimit të dokumenteve origjinale, vulosjes së zarfeve etj.
4. Vula vendoset vetëm mbi firmën/nënshkrimin e kryetarit ose nënkryetarit.
5. Në rast të konstatimit të humbjes apo dëmtimit të vulës, vihet menjëherë në dijeni kryetari dhe drejtori i ZABU-së, ku ky i fundit merr masat për zëvendësimin e saj sipas procedurës ligjore. Përveç sa më sipër, në rastet e humbjes së vulës bëhet dhe denoncimi në organet kompetente.

6. Vula dhe protokollit, administrohet nga punonjësi i protokollit të prefektit, kryetar i Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 25

Arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Vendimi, pas nënshkrimit nga drejtuesi i mbledhjes, ruhet dhe arkivohet në përputhje me legjislacionin në fushën e arkivave.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Vendimi paraprak ose projektvendimi i KBU-së, i cili propozohet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit, paraqitet në emër të KBU-së nga AMBU-ja.